

INTERVISTË E EMA BONINOS, DEPUTETE NË PARLAMENTIN EVROPIAN DHE ANËTARE E BORDIT DREJTUES TË GRUPIT NDËRKOMBËTAR TË KRIZAVE

# ËSHTË KOHA QË BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE TANI TË PRANOJË PAVARËSINË E KOSOVËS

**Eurodeputetja dhe anëtarja e Bordit të ICG-së thotë se zvarritja e zgjidhjes së statusit përfundimtar tashmë është tepruar dhe çdo zvarritje rrezikon paqen. Bashkësia ndërkombëtare nuk mund t'i legjitimojë fantazitë e Beogradit dhe Beogradi nuk ka të drejtë vetoje për statusin e Kosovës. Lidhur me procesin integruar evropian të Shqipërisë, eurodeputetja thotë se kjo qeveri ka punuar keq.**

“Kosova lëviz drejt pavarësisë që nga viti 1999. Është koha që bashkësia ndërkombëtare ta pranojë këtë. Serbia duhet të pranojë që e ka humbur Kosovën, ndërsa detyrë e Beogradit është që tani të punojë në favor të serbëve në Kosovë, e jo të fantazojë për mundësinë e rimarrjes së rajonit. Bashkësia ndërkombëtare nuk mund t'i legjitimojë fantazitë serbe, duhet para së gjithash të qartësojë se Beogradi nuk ka të drejtë vetoje në zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Çështja e Kosovës është zvarritur shumë gjatë”.

Kështu shkruan më 28 janar 2005 në gazetën prestigjioze “Corriere della Sera” deputetja e Parlamentit Evropian nga radhët e Partisë Radikale Transnacionale dhe njëherit anëtarja e Bordit Drejtues të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Emma Bonino. Kjo ka qenë arsyeja e intervistimit të saj. Ajo kërkon që statusi përfundimtar të përcaktohet sa më shpejtë, madje gjatë këtij viti, sepse zvarritja kaq e madhe e jep rezultate negative për paqen në Kosovë dhe në rajon. “Nëse viti 2005 nuk çon në arritjen e një zgjidhjeje përfundimtare e aftë për të konsoliduar paqen dhe zhvillimin, Kosova rrezikon të rreshqasë në një konflikt dhe të destabilizohet i gjithë rajoni”, - vlerëson ajo.

Bonino e ka ndjekur çështjen e Kosovës madje edhe nga afër. Në kohën kur është komisar evropiane, në prill të vitit 1999 ajo viziton të dëbuarit shqiptarë në Tropojë dhe Bllacë. Denoncon krimet serbe në Kosovë, denoncon ashpër gjenocidin serb në Bosnjë dhe mban një sërë protestash për ngritjen e Tribunalit. “Nuk ka paqe pa drejtësi”, është motivi i saj dhe i Radikalëve Transnacional që i përfaqëson kjo humaniste e madhe, luftëtare e pakompromis për të drejtat e njeriut dhe demokraci, kundërshtar e ashpër e diktaturave. Një vit pas Helmut Kolit i cili bas-

## TË MIRATOHET KUSHTETUTA PËR KOSOVËN E PAVARUR!

**Bonino që më parë ka kërkuar që të merret iniciativa për hartimin e një Kushtetute për Kosovën e Pavarur. Tani, pasi një grup konstitucionalistësh amerikanë i dorëzuan Presidentit Rugova një Draft-Kushtetutë, ajo thotë: “Draft-Kuashtetuta është vetëm hapi i parë. Kushtetuta duhet të marrë një legjitimitet nëpërmjet diskutimeve të gjera dhe të hapura dhe nga një referendum i gjerë pjesëmarrësish”.**



31 mars 1999, Bonino në Tropojë viziton të dëbuarit nga Kosova

hkoj Gjermaninë, një juri e kryesuar nga Zhak Delor, shpall Emma Boninon “Personalitet Evropian” të vitit 1996. Si njëra nga drejtueset e Grupit Ndërkombëtar të Krizave (GNK), Bonino mbështet fuqishëm raportin e fundit të GNK-së për pavarësinë e shpejtë të Kosovës. “Duhet filluar me përgatitjen e një Kushtetute për Kosovën e Pavarur”, - shkruan Bonino në artukullin autorial me titull “Beogradi të dorëzohet dhe të pranojë humbjen”.

**Bota Sot: Me një përvojë politike mbi 25-vjeçare, si ish-komisar evropiane, eurodeputete, a nuk ju duket se mospërcaktimi i statusit i shkakton dëme politike dhe ekonomike Kosovës?**

**Emma Bonino:** Po, dhe ky status quo nuk mund të qëndrojë gjatë pa shkakuar kriza. Ky është fakti pse unë mbështes rekomandimet e nxjerra nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave në raportin e tij të fundit. Por, përgjegjësia parësore tani u përket shqiptarëve të Kosovës për të dëshmuar se a është adekuat trajtimi i pakicave.

**Bota Sot: Besoni se në këto pesë vjet BE-ja ka dhënë kontribut të mjaftueshëm për Kosovën, para së gjithash në asistencën financiare?**

**Emma Bonino:** Një shumë e madhe parash e taksapaguesve evropianë kanë shkuar në Kosovë. Sigurisht që ne mundemi dhe duam, çështja është se a janë shpenzuar të gjitha ato me mençuri. Bashkimi Evropian sa më parë duhet të konsolidojë një prani tjetërfare dhe

qëllimet në Kosovë, për t'i dhënë një dorë menaxhimit të shtyllës së UNMIK-ut e cila është përgjegjëse për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

## BASHKIMI EVROPIAN BËN PRESION TË NJËANSHËM

**Bota Sot: Zonja Bonino, Beogradi ka dëshmuar se përpiqet vetëm për ta destabilizuar Kosovën, ndërsa në anën tjetër BE-ja duket se e tepron duke e përkëledhur Beogradin. E kam gabim?**

**Emma Bonino:** Do të ishte mirë që të shikohet më me kushtëzim ky lëshim i bërë nga Bashkimi Evropian. Trysnia për multietnicitetet është duke u bërë ashtu siç duhet ndaj Qeverisë së Kosovës, por kjo tryzni nuk bëhet me të njëjtën ekuivalencë edhe ndaj Qeverisë së Beogradit, i cili shpesh depërton për të gërryer çdo përpjekje të sinqertë për një multietnicitet në Kosovë.

Gjithashtu, është e rëndësishme gjithashtu t'i vënë theksin se a ka dalë një pjesë e institucioneve paralele serbe për shkak se shqiptarët, të cilët dominojnë strukturat qeveritare, nuk u kanë ofruar atyre shërbimet e nevojshme për të mbështetur komunitetin e tyre.

**Bota Sot: Në fund të janarit të këtij viti keni shkruar në Corriere della Sera se Kosova shkon drejt pavarësisë, bashkësia ndërkombëtare duhet ta pranojë këtë, ndërsa Beogradi nuk duhet të ndërrojë më për Kosovën. Sipas jush, cila është rruga më e shkurtyr për në pavarësi?**

**Emma Bonino:** Sigurisht, përndryshe nuk do t'i shkruaja këto fjalë! Por, nëse gjërat nuk rrjedhin në këtë mënyrë, atëherë është çështje tjetër. Gjithashtu duhet t'i kushtohet rëndësi aspektit se shpejtësia e lëvizjes drejt pavarësisë do të varet nga Kosova, duke treguar se është e aftë t'i trajtojë mirë pakicat. Nuk e kemi parë gjithmonë këtë.

**Bota Sot: Ju jeni për një Evropë të gjerë. Si do të jetë rruga e Kosovës drejt BE-së?**

**Emma Bonino:** Fati i Kosovës është i qartë, që të hyjë në Bashkimin Evropian në një të ardhme. Mëgjithatë, disa nga fqinjët e saj do të hyjnë më parë.

**Bota Sot: Krahasuar me vendet ballkanike, Shqipëria ishte shumë përpara tyre në rrugën drejt BE-së (deri 1997), ndërsa tani ka mbetur shumë prapa. Nuk ju duket se kjo qeveri punon keq?**

## FANTAZITË SERBE DUHET TË MARRIN FUND

**Duhet të pranojë që e ka humbur Kosovën, e jo të fantazojë për mundësinë e rimarrjes së rajonit. Bashkësia ndërkombëtare nuk mund t'i legjitimojë fantazitë serbe, duhet para së gjithash të qartësojë se Beogradi nuk ka të drejtë vetoje në zgjidhjen e statusit final të Kosovës”.**

## EMMA BONINO: FAKTET TREGOJNË KËTË, APO JO?

**Bota Sot: Çfarë do t'i kishit sugjeruar Shqipërisë në këto momente të afrimit me BE-në?**

**Emma Bonino:** Shqipëria duhet të dëshmojë se është e gatshme të jetë një partnere e besueshme në bashkësinë ndërkombëtare dhe t'i plotësojë detyrimet.

## KUSHTETUTA ËSHTË HAPI I PARË I PAVARËSISË

**Bota Sot: Maqedonia i dorëzoi Komisionit Evropian përgjigjet e Pyetësorit. Kur mund ta shohim në BE këtë vend të sapodalë nga konflikti ndëretnik?**

**Emma Bonino:** Në këtë fazë, janë inkurajuese menaxhimi i marrëdhënieve etnike dhe i disa çështjeve të tjera. Nëse mbahet kursi i tanishëm dhe vazhdoen reformat, vendimi për anëtarësimin e Maqedonisë në BE mund të merret në vitet 2009-2010.

**Bota Sot: Zonja Bonino, rishtazi ju keni shkruar se duhet një iniciativë për të përgatitur një Kushtetutë për Kosovën e pavarur. Konstitucionalistët amerikanë sot i kanë dorëzuar një kushtetutë të tillë Presidentit të Kosovës. Dua të them, çfarë duhet të bëjnë politikanët në Kosovë për ta realizuar pavarësinë sa më parë?**

**Emma Bonino:** Draft-Kuashtetuta është vetëm hapi i parë. Kushtetuta duhet të marrë një legjitimitet nëpërmjet diskutimeve të gjera dhe të hapura dhe nga një referendum i gjerë pjesëmarrësish. Kushti kryesor për pavarësinë e Kosovës është trajtimi i barabartë i pakicave. Qeveria e Kosovës duhet të dëshmojë qartazi angazhimin për implementimin e standardeve. /

Intervistoi: Hasan Saliu

